



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 56, Datë 17/04/2014

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

KONSTATON:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germat "a" dhe "c", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 32, datë 10.07.2013, që shtetasja [] ka paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër z. [], Drejtor i Spitalit Rajonal Vlorë, diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore.

Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në fund të procedurës së hetimit ka dalë Vendimi nr. 98, datë 09.10.2013, me anë të të cilit është vendosur: "Konstatimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë të znj. [], nga z. [], Drejtor i Spitalit Rajonal Vlorë, për shkak të gjendjes shëndetësore në fushën e punësimit". Në pikën 2 të këtij vendimi Komisioneri ka rekomanduar: "Kthimin në vendin e punës të znj. Tiftiri Rrokaj" si masë konkrete për të eliminuar situatën diskriminuese. Palët e interesuara kanë marrë dijeni për vendimin.

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe në pikën 3, të Vendimit nr. 98, datë 09.10.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtori i Spitalit Rajonal Vlorë, duhet të raportonte, brenda 30 ditëve, para Komisionerit për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke bërë me dije Komisionerin për masat e marra.

Me shkresën datë nr. 2724 datë 22.10.2013, z. [] drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por nga përmbajtja e shkresës, nuk raportohet asnjë veprim i ndërmarrë për të zbatuar vendimin nr. 98, datë 09.10.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën nr.549 prot, datë 30.10.2013, Komisioneri i kërkon z. P. ... të informojë para Komisionerit sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" për veprimet konkrete të ndërmarra prej tij për të eliminuar situatën diskriminuuese të konstatuar.

Me shkresën nr. 2838 prot, datë 01.11.2013, z. P. ... Drejtor i Spitalit Rajonal Vlorë, informon Komisionerin se nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim dhe vendim për rikthimin e znj. ... në marrëdhëniet e mëparshme të punës pasi Ministria e Shëndetësisë me Urdhrin nr. 506, datë 18.09.2013 "Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore", ka pezulluar procedurat e marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve.

Me shkresën nr. 318, datë 18.03.2014, Komisioneri ka kërkuar dhe një herë nga Spitali Rajonal Vlorë informacion mbi veprimet e ndërmarra për zbatimin e Vendimit nr. 98, datë 09.10.2013 të KMD-s, pasi në drejtim të spitalit ishte emëruar znj. ...

Me shkresën nr. 1338, datë 21.03.2014, znj. P. ... Drejtore e Spitalit Rajonal Vlorë, informon Komisionerin se e ka të pamundur të zbatojë rekomandimin e Komisionerit pasi Vendimi nr. 2264, datë 24.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (lënë në fuqi pasi nuk është ankimuar) ka vendosur për rrëzimin e kërkesës për kthim në vendin e punës të znj. ...

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri ju vë në dijeni se objekti i kërkesë padisë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nga shtetasja ... është bërë për kundërshtim dhe anulim të vendimit të Drejtorit të Spitalit Rajonal Vlorë për pushim nga puna pa shkaqe të arsyeshme dhe jo pretendime për konstatimin e faktit të diskriminimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 2264, datë 24.10.2013 është shprehur për përfitimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar nga shtetasja ... Në kushtet kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka gjykuar çështjen për konstatimin e faktit të diskriminimit, vendimi nr. 98, datë 09.10.2013 i KMD-s është i detyrueshëm për zbatim nga ana e Spitalit Rajonal Vlorë.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se znj. P. ... Drejtore e Spitalit Rajonal Vlorë, është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", pasi nuk ka zbatuar vendimin nr. 98, datë 09.10.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTË ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "ç", nenin 33, pikat 11,12,13/a e 14 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Spitali Rajonal Vlorë, të gjobitet me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Gjoba të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda datës 20.05.2014. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Zbatimi i vendimit nr. 98, datë 09.10.2013 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
4. Subjekti, Spitali Rajonal Vlorë, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

